

Data __. __. 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shtypshkrime”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Printime dhe shërbime të lidhura 79800000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 433 300 (nje milion e katerqind e tridhjetë e tre mije e treqind) lekë, pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Porttural Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros vjetore, për te pakten një nga vitet e periudhes se kerkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohej dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më pak se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohej vërtetime për realizim të suksesshem të kontratës të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jene te deklaruar ne organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2. Operoret ofertues të produkteve, kërkohet të jene të çertifikuar sipas normave **ISO 9001– 2015** të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit.

Dëshmia për zotërimin e saj duhet të jetë origjinale ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- ✓ ISO 9001-2015 është e nevojshme për garantimin e cilësisë së produkteve apo shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatat e mësipërme. Ky kriter është e lidhur ngushtësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në përpjestim me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe duhet të jenë të lëshuara nga autoritetet kompetente në mënyrë që të garantojë realizimin në kohe, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, si dhe minimalisht një teknik printimi të certifikuar të paktën 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit të tenderit

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

- 1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)
- 2 - Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët pjesmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojnë e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

4. Operatori ekonomik ofertues brenda datës dhe orës së hapjes së kësaj procedure duhet të paraqesë në Zyrës së Protokollit nga një mostër për zërat si më poshtë:

- 1) Axfordë
- 2) Bllok
- 3) Kartëvizita
- 4) Kartolina + Zarfa
- 5) Bazament për flamur tavoline
- 6) Stilolaps

Argumentim: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me pikën 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIM MBI MARRËVESHJEN KUADËR :

1. Marrëveshja kuadër do të lidhet me një operator ekonomik, pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: lista e artikujve, specifikimet teknike, si dhe sasi të që pritet të furnizohen.

2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë.

3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE, duke parë edhe natyrën e këtyre mallrave që përgjigjen nevojave imediate të AK kjo mund t'i shkaktonte kosto shtesë, pasiguri, dhe vështirësi autoritetit kontraktor, si p.sh. mospërputhje të artikujve të dhënë në bazë të rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

Afati i marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"

Grupi i Specifikimeve Teknike